

Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse

Rini e mbrojtur dhe e sigurt. Net

Sajber maltretimi

Sajber maltretimi

Jetojmë në një kohë kur të gjithë njerëzit e botës kanë mundësinë të komunikojnë me njëri-tjetrin me vetëm një të shtypur të sustës. Me arritjet teknologjike të kohës së fundit imponohet edhe një mënyrë e jetesës, e cila solli mënyra të reja të komunikimit edhe krijoi një koncept të ri për atë se ç'do të thotë komunikimi. Të rinjtë e sotshëm thuajse nuk mund ta paramendojnë jetën e përditshme pa kompjuterët e tyre, telefonat celular dhe pajisjet e ndryshme elektronike. Edhe pse shumëkush shikon në këtë mënyrë të ndërlidhjes sociale, të cilën e mundësoi teknologjia e re nëpërmjet rrjeteve sociale, si argëtim i padëmshëm, pas disa kontakteve virtuale të këtilla fshihet një kanosje e rrezikshme nga sajber maltretimi.

Nën termin, sajber maltretim nënkuptohen të gjitha aktivitetet të cilat nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjisë informatike dhe komunikuese i ndërmerr një individ i vetëm, ose një grup, me të vetmin qëllim që të përhapë sjellje joshqërORE të qëllimshme ndaj një individi tjetër, apo një grupi. Sajber maltretimi mund të paraqitet në forma të ndryshme, nga shqetësimet e drejtpërdrejta deri tek aktivitetet e tërthorta të cilat kanë për qëllim të dëmtojnë reputacionin e individit drejt të cilit janë drejtuar ose raportet që ai individ i ka me personat tjerë në mjedisin ku jeton. Edhe pse vetë fjala sajber maltretimi thuajse nuk ekzistonte deri para një dekade, sot problemi i sajber maltretimit bëhet gjithnjë e më prezent në përditshmërinë tonë, sidomos te popullata e re.

Edhe pse çdokush mund të bëhet pre e sajber maltretimit, numri më i madh i personave që janë viktime janë të rinjtë dhe në numrin më të madh të rasteve bëhet fjalë për sajber maltretim të moshatarëve. Kjo kryesisht është si pasojë e faktit se pikërisht të rinjtë janë ata të cilët në përqindje më të madhe i shfrytëzojnë teknologjitë bashkëkohore, por edhe të asaj se një përqindje e madhe e tyre e nënvlerësojnë rëndësinë e shfrytëzimit të përvojave mbrojtëse të internetit.


Kur bëjmë fjalë për sajber maltretimin e moshatarëve kjo më së shpeshti fillon që nga shkolla fillore, por jo rrallë herë ndodh edhe në shkollat e mesme dhe në fakultetet. Në një hulumtim të kryer nga Instituti Kalifornian për shkencat e integruara (California Institute for Integral Studies) në vitin 2010, te nxënësit e moshës 10 deri 18 vjeç, u morën të dhëna mahnitëse në të cilat 38% e nxënësve deklaruan se së paku një herë në jetën e tyre kishin qenë pre e sajber

maltretimit, ndërsa 32% kanë deklaruar se së paku njëherë kanë bërë një akt i cili do të paraqiste në një farë forme maltretim të një moshatari të tij duke përdorur mjetet bashkëkohore për komunikim.

Sipas Qendrës Hulumtuese për Sajber Maltretim në SHBA (Cyber Bullying Research Center) rreth 20% e nxënësve të hulumtuar në një hulumtim të tyrin të realizuar në vitin 2011, kanë deklaruar se së paku një herë në jetën e tyre kanë qenë viktimë e ndonjë forme të sajber maltretimit. Format më të shpeshta të sajber maltretimit kanë qenë komente të paparashikuara në rrjetet sociale (13,7%) dhe dhe përhapja e thashethemeve nëpërmjet të njëjtave rrjete (12,9%). Ajo çfarë gjithashtu ky hulumtim tregoi është se vajzat e reja në vitet e vonshme tinxheriane dhe në vitet e hershme të adoleshencës, kanë qenë më shpesh viktimat të sajber maltretimit në krahasim me moshatarët e tyre meshkuj (25,8% kundrejt 16%).

Shkolla Londineze për ekonomi (London School of Economics) në janar 2011 publikoi studimin e tyre të titulluar *Rreziqet dhe mbrojtja në internet*, i cili ishte realizuar në 25 shtet evropiane me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Studimi i hulumtonte qëndrimet, qasjet dhe përvojat e fëmijëve evropian të moshës 9 deri 16 vjeçare i kanë në lidhje me temën e sajber maltretimit. 9% e fëmijëve të hulumtuar kanë deklaruar se së paku njëherë kanë marrë një porosi ofenduese nëpërmjet internetit, ndërsa 3% kanë deklaruar se së paku njëherë i kanë dërguar dikujt një porosi me përmbajtje ofenduese nëpërmjet internetit. Gjysma e atyre që kanë pranuar një porosi ofenduese nëpërmjet internetit kanë deklaruar se e njëjta i ka shqetësuar jashtë zakonisht shumë. Ata të cilët kanë qenë pre e sajber maltretimit në një përqindje të madhe janë maltretuar nëpërmjet ndonjë rrjeti social sesa nëpërmjet e-mailit, web faqe për lojëra ose ndonjë forumi.

Ajo që e dallon sajber maltretimin e moshatarëve ose sajber dhunën nga llojet tjera të dhunës së moshatarëve është ajo se sajber dhuna mund të ndodhë në çdo kohë, pavarësisht nëse viktimat është e pranishme ose jo, edhe atë se e njëjta mund të ndodhë nëpërmjet një spektri të gjerë të platformës komunikuese: fotografive, teksteve, video ose audio regjistrimeve. Kryerësi i aktit të dhunshëm mund të mbetet anonim, pikërisht për faktin që një numër i madh i rrjeteve sociale lënë hapësirë për krijimin e lehtë të profilit të rrejshëm, dhe pikërisht personat të cilët kanë tendencë për të qenë të dhunshëm janë persona të cilët njëkohësisht kanë tendencë për të dhënë informata të rrejshme gjatë regjistrimit në shumë platforma sociale. Njëra nga arsyet që kjo formë e dhunës së moshatarëve është në rritje e sipër, është pikërisht edhe për faktin se iu mundësohet dhunuesve të ngelen të pazbuluar. Forma më e shpeshtë e sajber maltretimit është nëpërmjet



Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse


porosive në platformat siç janë Facebook dhe Twitter dhe platformat të cilat mundësojnë shkëmbimin e instant porosive.

Ka numër të madh të të rinjve, si edhe të prindërve dhe arsimtarëve të tyre, të cilët ende mendojnë se sajber maltretimi nuk është edhe ndonjë problem i madh, pasojat të cilat mund të paraqiten nga kjo formë e dhunës janë të paparashikueshme. Edhe pse në një çast sajber maltretimi do të ndërpritet, frika, lëndimi dhe kujtesa nga e njëjta, te personi i cili ka qenë viktimë e një forme të maltretimit të tillë ngelen për një kohë të gjatë, dhe mund të paraqesin një ortek të vërtetë të vështirësive psikologjike të mëtejshme.

Shpërndarja anonime e postimeve të cilat shpejt mund të përhapen te një numër i madh i njerëzve, e bënë këtë formë të dhunës që të përjetohet nga ana e personit viktimë edhe më kërcënuese dhe emotivisht më shqetësuese. Përveç kësaj, porosite, fotografitë dhe video materialet të cilat janë postuar njëherë nuk mund që tërësisht të fshihen, edhe sikur të arrihet që tërësisht të fshihen është e mundur që dëmi i bërë nga ato tani më të jetë shkaktuar. Sajber maltretimi është problem serioz i cili viktimat e tij shpeshherë i lë me ndjenja të mbushura me mosbesim dhe turp.

Të rinjtë në zhvillim, që janë viktimat të ndonjë forme të sajber maltretimit shpeshherë nuk janë në gjendje të përballen me këto ndjenja negative vërshuese, që nga ana tjetër bartë mundësinë për paraqitjen e depresionit, ndërsa në disa raste, varësisht nga personi, struktura e viktimës mund të zhvillohet deri në tendenca vetëvrasëse. Fatkeqësisht në përmasa botërore, çdo vit numri është më i madh i të rinjve të cilët kryejnë akte vetëvrasëse, pikërisht nga paaftësia për t'u bartur me pasojat të cilat janë iniciuar nga ndonjë formë e sajber maltretimit të moshatarëve.

Personi viktimë e sajber maltretimit mund ta zvogëlojë shkallën e vetëvlerësimit, si edhe të nxisë një mori të problemeve shëndetësore psikologjike. Këto persona, si pasojë e ngarkesës negative emotive kanë vështirësi në përqendrim (fokusim) dhe kanë vështirësi që të koncentrohen, e cila veti më së shpeshti rezulton me rënien e suksesit shkollor. Kanosjet anonime në internet, gjithashtu provokojnë që mjedisi të përjetohet si një rreth i rrezikshëm dhe i pasigurt, e cila gjithashtu nxit që viktimat edhe më tepër të mbyllet në vete edhe të mos hapet me të tjerët, duke mbledhur gjithçka në vete. Për t'u ballafaquar me këtë, personat viktimat fillojnë që të zhvillojnë raporte largimi ndaj mjedisit në të cilin jetojnë, i cili shpeshherë rezulton me ikjen nga orët mësimore, ikja nga moshatarët, mësuesit, prindërit dhe ngjashëm. E gjithë kjo nga njëra anë krijon



Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse

hapësirë të mirë për të zhvilluar varshmëri, dhe kështu është i rëndësishëm numri i tinejxherëve viktimave të sajber maltretimit të cilët fillojnë të konsumojnë alkool ose lëndë narkotike.

Pasojat nga sajber maltretimi i moshatarëve aspak nuk janë shqetësuese, dhe pikërisht nga kjo, lufta kundrejt sajber maltretimit është shumë e rëndësishme, dhe duhet marrë seriozisht. Personat që janë, ose kanë qenë, viktimë të kësaj forme të dhunës gjithashtu mund të kontribuojnë shumë në luftën kundër kësaj forme të dhunës, në atë mënyrë që do t'i injorojnë këto porosi, tekste ose mendime dhunuese në hapësirën virtuale për bisedim. Kjo nuk do të thotë që ata duhet të tërhiqen dhe të vuajnë, por zëshëm të paraqiten dhe të kërkojnë ndihmë nga prindërit, mësuesit dhe institucionet adekuate.

Sido që të jetë, mënyra më e mirë e ballafaqimit me sajber maltretimin e moshatarëve është që sa më tepër të rinjtë të mësojnë si t'i shmangen dhe të mos bienë viktimë e kësaj forme të dhunës. Mënyra më e suksesshme është që të intervenohet paraprakisht për të mos u bërë viktimë e ndonjë forme të sajber dhunës së moshatarëve është që fillimisht në mënyrë aktive të zbatohen internet praktikat për mbrojtje. Të kihet kujdes ndaj përshtatjes së mbrojtjes së profilit në rrjetet sociale siç janë Facebook dhe Twiter, kush ka qasje për t'i lexuar postimet tuaja, kush mund t'i shohë dhe t'i shpërndajë fotografitë tuaja, si dhe kush mund të shënojë komente. Por, megjithatë, preventiva më e mirë qëndron në atë që të mbajmë llogari se çfarë ndajmë me të tjerët në rrjetet sociale dhe me kë e ndajmë, përkatësisht të mos nxjerrim diçka për të cilën as ne vetë nuk jemi të sigurt se duam që të jetë e parë dhe e komentuar nga çdokush.